

**STATUTI**  
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**GJERGJI-IMPEX shpk.**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI1**

**EMERTIMI**

Sot me dt 18.11.2013 ne baze te ligjit nr, 9723 date 03.05.2007«Per Q.K.R.» te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 « Per shoqerite tregtare » me vullnetin e tij te lire te shprehur ne nenshkrimet e ketij statute.

Shoqeria e ka seline ne Dobraç, tek tregu fruta-perime dhe njihet me emrin **GJERGJI-IMPEX shpk.**

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX shpk** ka te drejte te çel filial dege e perfaqesi ne qytetete tjera te Shqiperise e jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar e ato te vendeve te tjera kuato do te hapen.

Z. Sokol Zhuja eshte administrator e shoqerise per afat 5 vjeçar.

**NENI 2**

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX shpk** e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj (statutit).

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX shpk** eshte person juridik.

**NENI 3**

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX shpk** krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per njekohezgjatje mbi 10 vjet.



Shoqeria **GJERGJI-IMPEX** shpk mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose mund ta mbylle aktivitetin e saj para ketij afati, sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kritereve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 4**

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX** shpk per detyrimt qe do te lindin gjate aktivitetit me te tretet, per gjigjet vetem me pasurine e saj.

Ortaket e shoqerise nuk per gjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tyre qe nuk eshte futur ne kapitalin e shoqerise.

Pjesmarrja me kete shoperi nuk pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria **GJERGJI-IMPEX** shpk do te kete si objekt:

**Import eksport, fruta perime. Mallra industrial. Lende ndertimi, shitje me shumice dhe pakice. Punime ndertimi, tregtim I materialeve te ndertimit etj**

#### **KREU II**

#### **MARDHENIET EKONOMIKE-FINANCIARE**

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar i shoqerise **GJERGJI-IMPEX** shpk eshte 100.000 Leke.

I ndare ky kapital ne 100 pjesa, vlera nominale e sejçiles eshte 1000 leke.

Ky kapital themelor zoterohet nga ortaku i shoqerise i ndare ne masen 100 % (njeqind perqind) secijli.

Z. Sokol Zhuja 100 %

Kapitali themeltar ose pjesa te caktuara te tij e jane te transferueshme si ndermjet nga ortakeve ashtu dhe perkundrejt personave te trete.

Transferimi I kapitalit ose pjesave te tyre ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me miratim te ortakeve dhe me akt notarial.



Ne qofte se njeri nga ortaket deshiron te shese kuotat e kapitalit te tije, duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere, ose aprosimin e tyre unanim per shitjen e pjeses se tij e nje subjekti tjeter.

Vleresimi I kapitalit themeltar ne natyr behet nga ortaket ne nje marrveshje te vecante ose nga nje ekspert kompetent i caktuar nga ortaket.

#### **NENI 7**

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar behet me vendimas amblese se ortakeve.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje rregjister te vecante.

#### **NENI 8**

Fitimet neto I realizuarnga aktiviteti I shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me kuotat e tyre takuese ne kapitalin themeltar.

#### **NENI 9**

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

Bilanci I aktivitetit te shoqerise pergatitet ne fund te vitit e duhet te dorezohet brenda muajit mars te vitit qe vijon.

Bilanci I aktivitetit finanziar mund te behet nga vete ortaket ose nga eksperte e tyre.

Por ne tegjitha rastet, rezultatet e bilancit finanziar duhet ti behen te aprovoohen nga Asambleja e ortakeve Brenda muajve te mbylljes se vitit finanziar.

#### **NENI 10**

Shoqeria krijon fonde e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Perberja e fondevet, burimet financiare te tyre, caktohen nga asambleja e ortakeve.



## **NENI 11**

Shoqeria I disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

## **KREU II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKVE**

#### **NENI 12**

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtrohen neper mjetve ndimeve te marra nga Asambleja e Ortakve.

-Te marrin pjesë ne administrimin e veprimitarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin.

-Te kerkojne dhe t'u jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimitarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci, libra. llogarie).

-Te bejne propozime dhe t'I paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblese se Shoqerise.

-Te heqin dore nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne kete statut.

## **NENI 13**

Ortaket kane keto detyra kryesore:

-Te depozitojne kuoten e tyre ose kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe me vendimet e Asamblese (per fondin rrezerve).

-Te marrin pjesë ne administrimin e shoqerise neper mjet organeve te krijuara nga ata vete.

-Te respektojne detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori per realizimin e detyrave te shoqerise.

## **KREU IV**

### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERISE**

#### **NENI 14**

Organi me i lartevendimor I shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Ne asamble marrin pjese te gjithe ortaket me te drejte vote sipas shumave te vena ne kapitalin themelor te shoqerise. Asambleja e ortakeve kryen keto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor te shoqerise.
- Vendos per shtimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emeron dhe revokon Administratorin e shoqrise.
- Emeron dhe revokon Ekspertin kontabelte Shoqerise.
- Kryen modifikime ne statutsi pas ecurive te shoqerise si dhe kontroll te shoqerise.
- Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise ose shnderrimin e saj ne nje tip tjeter shoqerie.

#### **NENI 15**

Administratori I shoqerise perfaqeson shoqerine ne marrdhenie me te tretet dhe ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne e me dhe per llogarite shoqerise.

Shoqeria merr persiper te gjitha pergjegjesite qe te mund te vij ne nga veprimet e kryera nga administratori.

Administratori ka afat maksimal 5-vjet dhe afati eshte I detyrueshem te parashikohet ne aktet e shoqerise.

#### **NENI 16**

Administratori eshte pergjegjesi individualisht ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate veprimeve te tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjate administrimit te shoqerise.

#### **NENI 17**

Marredheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise **GJERGJI-IMPEX** shpk rregullohen me kontrata individuale, qe do te lidhen me secilin prej tyre.

KREU V

**MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE**

**NENI 18**



Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate ne qofte se ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk zgjatin kete afat.

Shoqeria mund ti jap fund aktivitetit te saj dhe para afatit te percaktuar ne aktin e themelimit, me aprovin e Asamblese se Ortakeve.

### NENI 19

Kur shoqeria likujdohet plotesisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit ne te cilin paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e shoqerise, pasi shlyhen detyrimet e shoqerise, do te ndahet mes ortakeve ne proporcion me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejte shfrytezimi i kthehet pronar e vete saj.

### ORTAKU I SHOQERISE

Sokol Zhuja

